



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Nr. 3783 Prot

Tiranë, më 30/11 2018

**Lënda:** Amendament për projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar”

**Drejtuar:** z. Gramoz RUÇI

**KRYETAR I KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

I nderuar z.Kryetar,

Mbështetur në nenin 75, pika 4, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, propozoj që në projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr.9981, datë 8.9.2008, “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

- Në nenin 1, tabela që i bashkëlidhet ligjit nuk miratohet:

**Argumenti**

Ky projektligj bie në kundërshtim me ligjin nr. 9590, datë 27.03.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim -Asociimit” konkretisht me kapitullin III, nenet 32 dhe 33, pika 1, ku thuhet:

Neni 33

Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, nuk vendosen detyrime të reja për importet ose eksportet, ose tarifa të reja me efekt të njëjtë me to dhe nuk rriten as ato që zbatohen tashmë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë.

Gjithashtu, projektligji duhet të mbante në konsideratë edhe detyrimet që ka vendi ynë me Organizatën Botërore të Tregtisë, që edhe për rastet e unifikimit të tarifave doganore, për kodet tarifore 18418, tarifave të mos jetë më e lartë se 5 për qind.

**DEPUTETI**

Erjon BRACE